

17 ekspertë në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurrimin për 17 (shtatëmbëdhjetë) vende të lirë pune në përdorimin e teknologjive të avancuara.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Harton rregullat që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të.
2. Të përpunojë dhe të analizojë informacionin gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj., të vëna në dispozicion nga institucione shtetërore si dhe të krijuara nga ASIG-u, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj, bazuar në manualët apo praktikatat më të mira në përputhje me standartet europiane.
3. Të shpërndajë informacionin e përpunuar gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë etj., për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.
4. Të hartojë dhe të propozojë Draft/akte-nënligjore/manualë, në bashkëpunim me institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, për mënyrën e përdorimit të informacionit të përftuar nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar bazuar nga pervoja nderkombetare dhe situata brenda vendit.
5. Kujdeset për rritjen dhe ruajtjen e njohurive profesionale, të kuptuarit teknik dhe njohuritë praktike të punës, të metodologjive dhe përvetësimit të teknikave që lidhen me parimet dhe përdorimit të metodat e GIS dhe të Remote Sensing për të analizuar të dhënat gjeohapësinore dhe për të zgjidhur problemet për projektet që përfshijnë tematika të ndryshme.
6. Përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të zotërojë diplomë “Master profesional”/ Shkencor në:
 - Gjeodezi,

- Gjeoinformatik,
- Gjeomatik,
- GIS
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri të thelluara teorike dhe praktike lidhur me proceset e domosdoshme në përdorimin e teknologjive të avancuara (Remote Sensing).
- Të ketë njohuri të legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinor.
- Të ketë njohuri të thelluara në përdorimin e softuerit për analizimin e imazheve satelitore, imazhe te perftuara nga teknologjia UAV (drone) ose Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) si: ArcGIS, QGIS, ERDAS, ENVI, etj. për të vlerësuar dhe analizuar të dhënat e marra nga sistemet Remote Sensing.
- Të ketë njohuri të thelluara teorike lidhur me transformimin e informacionit gjeohapësinor nga një reference gjeodezike në një tjetër.
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, propozimi dhe manaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi
- Të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 05.06.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.